

EFTALI QIRJAJI



Adresa: Lagje "Qemal Stafa", Rr. "Studenti",

Shkodër, Albania

Tel +355 2 22 417 46

Cel. 06902079434, Cel 0692069434


e-mail: eliqirjaqi@yahoo.com



RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR

Për Auditimin e Fondeve të Përfituara dhe Shpenzuara
Për Fushatën Zgjedhore 2015

PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE



Shkodër 26 Tetor 2015



RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR MBI ANGAZHIMET E AUDITIMIT PËR QËLLIME TË VEÇANTA

DREJTUAR KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Bulevardi: "Dëshmoret e Kombit"

Pallati i Kongreseve, Tiranë

Të nderuar zotërinj,

Në cilësinë e Ekspertes Kontabël të Regjistruar, bazuar në Vendimin nr.969, dt.10.08.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe Kontratës të Shërbimit Nr.7705, dt.28.09.2015, kam audituar pasqyrat që lidhen me financimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, që fillon me datë 21.05.2015 me regjistrimin e "Partisë Demokratia Sociale" në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (si subjekt zgjedhor) dhe mbyllet me datë 20.06.2015 me përfundimin e fushatës zgjedhore të 21 Qershor të vitit 2015.

Përgatitja e këtyre pasqyrave është përgjegjësi e drejtuesve të Partisë Demokratia Sociale. Pasqyrat e fondeve të përfituara dhe shpenzuara dhe librat përmbledhës të aktivitetit financiar janë përgatitur nga drejtimi i Partisë Demokratia Sociale dhe pasqyrojnë të gjitha transaksionet në lidhje me fushatën zgjedhore.

Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin e kryer. Auditimi u krye në përputhje me Standartet Nderkombetare të Auditimit, referencë të vecantë me SNA 800. Këto standarte kërkojnë që unë të planifikoj dhe të kryej auditimin për të zotëruar siguri të arsyeshme, se pasqyrat e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazen e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara që përfshijnë: Librin e llogarive të subjektit, regjistrin e posacëm të miratuar si model, me vendim nr.266 të KQZ-së, dt.01.06.2009 si dhe pasqyrën e arkëtimit pagesave. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Unë çmoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tim të auditimit.

OPINION

Pasqyra e fondeve të përfituara dhe shpenzimeve tw kryera për fushatën zgjedhore të Partisë Demokratia Sociale që fillon me dt.21.05.2015 dhe mbyllet me dt. 20.06.2015 është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit financiar, konform ligjit nr.9228 dt.29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" me rekomandimet në lidhje me dokumentimin e shpenzimeve sipas kërkesave të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

Eksperte Kontabël e Regjistruar

Eftali QIRJAQI



Shkodër, me 26/10/2015



I. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

I.1 Baza ligjore për kryerjen e këtij misioni është marrë në referim të ligjeve:

- Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".
- Ligji nr.8580, dt.17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar me ligjin Nr.10374, date 10.02.2011.
- Ligji nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar", Standartet Ndërkombetare të auditimit dhe kryesisht (SNA 800).
- Ligji Nr. 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finciare,,
- Cdo dokument ligjor të marrë pranë Partisë Demokratice Sociale

I.2 TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SUBJEKTIN ZGJEDHOR

Subjekti zgjedhor Partia Demokratice Sociale e ka fituar zotësinë juridike për të vepruar në bazë të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me Nr.1965 date 07/05/2003. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit nr. 8580, dt.17.02.2000 "Për Partitë Politike", të Ligjit nr.8788, dt.07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimpruese", të Ligjit nr.8779, dt.07.05.2001 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimpruese", nga statuti i saj dhe legjislacioni ne fuqi. Partia Demokratice Sociale eshte pajisur me NIPT K72127451T.

Qëllimi: Partia Demokratice Sociale mbron interesat politike, ekonomike, social kulturore të shtresave të ndryshme të shoqërisë shqiptare. PDS kontribuon për paqen dhe qytetarinë në luftë kundër diskriminimit të të gjitha llojeve: racor, fetar, kulturor, seksual etj. PDS lufton për të krijuar mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e Republikës së Shqipërisë. PDS synon rritjen e nivelit të jetesës përmes luftës kundër varfërisë, forcimin e familjes dhe unitetit shoqëror përmes reformave ekonomike, shoqërore, edukimit dhe kulturës, konkurrencës dhe një adresimi publik dhe efikas.

Selia e partisë është në Blv. Zogi I, ish Klinika Dentare, kati 3, Tiranë

Organet drejtuese në udhëheqjen qendrore janë:

- Kongresi i anëtarësisë së partisë
- Asambleja kombëtare e partisë
- Komiteti drejtues kombëtar
- Bordi ekzekutiv kombëtar
- Kryetari i partisë
- Sekretari i përgjithshëm dhe sekretarët e partisë
- Komisioni i mbrojtjes statutore

Kryetar i partisë është zgjedhur z.Paskal Milo.

Të ardhurat Financiare të Partisë sipas statutit përfitohen nga :

- Të ardhurat nga kuotizacionet
- Të ardhurat nga buxheti i shtetit në përputhje me legjislacionin për financimin e partive politike
- Ndhimat dhe dhuratat e anëtarëve e përkrahësve të PDS-së



- Ndhimat dhe dhuratat e organizatave partnere
- Çdo e ardhur që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin për financimin e partive politike

II. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABËL

II.1 Mënyra e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare

- a) Pasqyrat e fondeve të perfituara dhe të shpenzuara janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me ligjin nr.9228 dt. 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare,, dhe Ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë". Pasqyrat e paraqitura në raport janë shprehur në monedhen vendase në Lekë.
- b) Rregullat e vlerësimit të likuiditeteve.
Gjendjet e likuiditeteve përfshijnë gjendjen e parave në arkë dhe në llogaritë rrjedhëse në bankë në lekë. U kontrolluan veprimet e kryera në arkë dhe bankë dhe u konstatuan se regjistrimet në librat e llogarive dhe në ditarët përkatës ishin kryer sipas normave kontabël.
- c) Të Ardhurat
Të ardhurat regjistrohen sipas masës së përfitimit të tyre nga fondet publike ose jopublike.

II.2 Organizimi i Kontabilitetit

Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare". Partia regjistron shpenzimet mbi bazën e arkëtimit pagesave. Partia ka ndërtuar një plan të llogarive vetjake në përputhje të plote me Planin Unik Kontabël. Kontabiliteti mbahet në excel.

III. VERIFIKIMI I PASQYRËS SË FONDEVE TË PËRFITUARA DHE SHPENZIMEVE TË KRYERA

III.1 FONDET E PËRFITUARA GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE 2015 (deri me 26/10/2015)

Përshkrimi sipas natyrës		
Nr.	Natyra e të ardhurave	Vlera
1	Fondet e përfituara	
1.1	Nga fondet publike	4,474,495
1.1.1	Fondi për fushatën zgjedhore 2015	4,474,495
1.2	Donacionet e përfituara në vlerë monetare	0
1.2.1	Donacionet nga persona fizikë dhe juridikë vendas	0
1.2.2	Mjete monetare të krijuara nga aktiviteti i subjektit zgjedhor	0
1.2.2.1	Fonde të krijuara nga kartat e anëtarësisë dhe kontributet e anëtarëve	0
1.2.2.2	Fonde të krijuara nga marrëveshjet me palët e treta	0
1.3	Donacionet e përfituara në sende dhe shërbime të vlerësuara me vlerë tregu	0
1.4	Përfitime nga reklama televizive sipas nenit 84 pika 6	0
1.5	Të tjera	0
Shuma totale e fondeve		4,474,495

4



1. Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet publike

Në ligjin Nr.10091, datë 29.12.2008 Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Neni 87 "Shpërndarja dhe rishpërndarja e fondeve publike që i shpërndahet secilit për subjektet zgjedhore" pika 2 shpreh "Sasia e fondeve publike që i shpërndahet secilit prej subjekteve zgjedhore caktohet me vendim të KQZ-së, sipas rregullave të mëposhtme"

Konstatoj:

Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti ka qenë përfitues i fondeve publike të arkëtuara në llogarinë bankare Tirana Bank Lek me numër Iban AL43206110040000100302504100 si më poshtë:

Institucioni	Shkresa	Datë	Vlera	Data arkëtimit
Ministria Financave, DPB	Nr.4607/1 Prot	30/03/2015	3.568.436 Lek	03/04/2015
Ministria Financave, DPB	Nr.8571/1 Prot	10/06/2015	2.227.395 Lek	26/06/2015

Bazuar në Nenin 87, pika 6 të Kodit Zgjedhor, sipas rillogaritjes së fondeve publike për partitë politike pas rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015, Partia Demokracia Sociale duhej të kthente fondet publike në masën 1.321.336 Lek sipas shkresës Nr.7653 Prot. Datë 21/09/2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kjo shumë është kthyer në përfitim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me datë 26/10/2015.

2. Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike

Në ligjin Nr.10091, datë 29.12.2008 Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Neni 89 "Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike" konstatohet se:

Neni 89 pika 1 shpreh:

Subjektet zgjedhore mund të marrin, për qëllime të fushatës të tyre zgjedhore, fonde vetëm nga persona fizikë ose juridikë vendas. Për qëllim të këtij Kodi, konsiderohet person fizik vendas edhe shtetasi shqiptar me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Konstatohet:

Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti nuk ka qenë përfitues i asnjë fondi për qëllime të fushatës zgjedhore nga persona fizikë apo juridikë vendas, kjo sipas deklaratimit të përfaqësuesit si dhe të regjistrimit të dhurimeve nënshkruar nga PDS dhe historikut të llogarisë bankare deri në datën e raportit.

Neni 89 pika 2 shpreh:

Shuma që çdo person fizik apo juridik mund t'i japë një subjekti zgjedhor nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë ose kundervlefata në sende ose shërbime.

Konstatohet:

Subjekti nuk ka qenë përfitues i asnjë fondi për qëllime të fushatës zgjedhore nga persona fizikë apo juridikë.

Neni 89 pika 3 shpreh:

Ndalohej dhënia e fondeve nga një person juridik apo cdo aksionar i tij nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme:

5 |



- a) Ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncensione në 2 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milion lekë;
- b) Ushtron veprimtari në fushën e medias;
- c) Ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme
- d) Ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit ose ndaj cdo institucioni publik.

Konstatohet:

Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti nuk ka qenë përfitues i asnjë fondi për qëllime të fushatës zgjedhore nga persona juridikë apo cdo aksionar i tij i cili ndodhet në kushtet e mësipërme.

III.2 SHPENZIMET E KRYERA PËR FUSHATËN ZGJEDHORE 2015 (deri me 26/10/2015)

Pershkrimi sipas natyrës

Nr.	Natyra e shpenzimeve	Vlera
2	Shpenzimet e kryera	
2.1	Paga e Shpërblime për fushatën zgjedhore	98,000.0
2.2	Qera salle për fushatën zgjedhore	43,000.0
2.3	Flamuj, bluza, postera, fletëpalosje, reklamë, banderola e materiale të tjera	403,476.0
2.4	Shpenzime telefonike dhe internet	13,352.0
2.5	Shpenzime energji ujë	14,672.0
2.6	Shpenzime kancelari	33,180.0
2.7	Shpenzime udhëtime dieta	331,178.4
2.8	Sherbime riparime pj.këmbimi karburant	671,309.0
2.9	Taksa vendore	22,877.0
2.10	Komisione bankare	4,003.3
2.11	Të tjera	1,401,615.6
	Shuma totale e shpenzimeve	3,036,663.3

Shpenzimet e kryera jane bazuar në fatura të rregullta tvsh-je, fatura të thjeshta tatimore, kupona tatimore, mandat pagesa dhe urdhra të brendshëm ekzekutivë.

Menaxhimi u pajis me një letër rekomandimi nga audituesi në lidhje me përmirësimet që mund të bëhen mbi mbajtjen e dokumentacionit në përputhje me legjislacionin fiskal.

III.3 PASQYRA E MJETEVE MONETARE

Partia Demokracia Sociale ka vepruar nëpërmjet llogarisë bankare në Tirana Bank lek me numër Iban AL43206110040000100302504100.



Nga verifikimi i likuiditeteve në arkë dhe bankë rezultojnë lëvizjet si më poshtë:

	Në fillim të periudhës 01/01/2015 Lek	Hyrje fondesh 01/01/15- 20/06/15 Lek	Kthim fondi Lek	Pagesa shpenzimesh 01/01/15- 20/06/15 Lek	Në fund të periudhës 20/06/2015 Lek
Depozita në arkë + bankë (per fushaten)	839,819.11	3,568,436	-	1,807,455.71	2,600,799.40
Totali	839,819.11	3,568,436.00	0.00	1,807,455.71	2,600,799.40

	Në fillim të periudhës 01/01/2015 Lek	Hyrje fondesh 01/01/15- 26/10/15 Lek	Kthim fondi 01/01/15- 26/10/15 Lek	Pagesa shpenzimesh 01/01/15- 26/10/15 Lek	Në fund të periudhës 26/10/2015 Lek
Depozita në arkë + bankë (per fushaten)	839,819.11	5,795,831	1,321,336	3,036,663.30	2,277,650.81
Totali	839,819.11	5,795,831	1,321,336	3,036,663.30	2,277,650.81

IV. PERIUDHA E AUDITIMIT

Për arsye të specifikave të fushatave zgjedhore por edhe të politikave tregtare të palëve të treta me të cilat është bashkëpunuar, periudha që mbulon auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzimeve të kryera përfshin periudhën 01/01/2015 deri me 26/10/2015. Pavarësisht se fushata zgjedhore përfshin datat 21/05/2015 deri me 20/06/2015, periudha e auditimit është zgjeruar duke përfshirë periudhën para dhe pas fushatës elektorale sepse është tregues i transaksioneve të konstatuara që i përkasin përfitimeve dhe shpenzimeve për fushatën zgjedhore dhe si rezultat japin një pamje më të sinqertë dhe të vërtetë të fondeve të fituara dhe shpenzuara.

Eksperte Kontabël e Regjistruar

Shkodër, me 26/10/2015

Eftali QIRJAQI

